



UK Health
Security
Agency



Ekziston një vaksinë që ju mbron nga dhimbjet e shkaktuara nga

Herpesi



NHS ofron një vaksinë që ul rrezikun e shfaqjes së herpesit.

Në këtë fletëpalosje tregohet programi kombëtar kundër herpesit, dobitë e vaksinës dhe kush kualifikohet.

Vaksina aktuale për programin kundër herpesit quhet Shingrix.

Për të pasur mbrojtjen më të mirë, ju duhen 2 doza të Shingrix.

Mjeku juaj i përgjithshëm do t'ju kontaktojë nëse kualifikoheni. Gjithashtu mund të jeni në gjendje t'i bëni vaksinat Shingrix në disa farmaci.



Ndryshe nga shumica e infeksioneve të tjera, herpesin nuk e merrni nga dikush tjetër. Shumica prej nesh e kanë kaluar linë kur kemi qenë të vegjël, edhe pse disa mund të mos e kenë kuptuar.

Pasi kalon linë, virusi qëndron i përgjumur duke jetuar në nerva. Për pjesën më të madhe të jetës nuk je në dijeni të kësaj, por herë pas here virusi mund të rishfaqet dhe të përhapet në lëkurë duke shkaktuar një sëmundje të quajtur herpes.

Herpesi mund të shkaktojë shumë dhimbje dhe ka prirjen t'i prekë më shumë njerëzit ndërsa rriten në moshë. Arsyeja mund të jetë sepse sistemi imunitar dobësohet me kalimin e moshës, nga stresi ose nga një sërë problemesh dhe trajtimesh mjekësore. Për disa, dhimbja që shkaktohet nga herpesi mund të zgjatë shumë vjet. Herpesi mund të ndikojë te jeta juaj, duke mos ju lejuar të bëni gjërat që zakonisht ju pëlqejnë.

Çfarë e shkakton herpesin?

Herpesi (i njohur gjithashtu si herpes zoster) shkaktohet nga virusi i përgjumur i lisë që përhapet në një pjesë të lëkurës që lidhet me një nga nervat. Bën që disa pjesë të lëkurës të shkaktojnë shumë dhimbje dhe kruajtje, dhe të mbushen me qelb. Këto filluska mund të çahen dhe të kthehen në plagë që me kalimin e kohës zënë kore dhe më pas shërohen. Zakonisht këto filluska prekin njërën anë të trupit, më tepër në krahë, por ndonjëherë edhe në kokë, në fytyrë dhe në sy.

Çfarë pamjeje ka herpesi?



Sa zgjat dhe sa serioz mund të jetë?

Shenjat e para të herpesit mund të jenë një ndjesi e përgjithshme jo e mirë e shoqëruar me therje ose djegie në një pjesë të lëkurës në njërin anë të trupit. Zakonisht, pas simptomave të para shfaqet një skuqje në lëkurë e dhimbshme me filluska të mbushura me qelb.

Herpesi në trup mund të shkaktojë dhimbje të rënda. Nëse herpesi shfaqet në sy dhe në kapakun e syrit, mund të shkaktojë dobësim të shikimit e madje verbim të përhershëm në atë sy.

Sa shpesh ndodh herpesi?

Rreth 1 në 5 vetave që kanë kaluar linë do t'u shfaqet herpesi. Kjo do të thotë që çdo vit në Angli dhe Uells, dhjetëra mijëra njerëz sëmurën me herpes. Edhe pse herpesi mund të ndodhë në çdo moshë, rreziku, ashpërsia dhe komplikacionet e herpesit rriten me kalimin e moshës.

Neuralgjia post-herpetike (PHN)

Çdo vit, rreth 14,000 njerëzve u shfaqet neuralgjia post-herpetike (PHN) pas herpesit dhe mbi 1,400 shtrohen në spital për shkak të PHN.

Shumica e njerëzve shërohen plotësisht brenda pak javësh, por për disa dhimbja vazhdon me muaj ose vite – kjo quhet neuralgjia post-herpetike (PHN). Kjo është një gjendje mjaft e pakëndshme që shoqërohet me dhimbje nervore ngjashëm djegies, pulsimit ose shpimit.

Sa më të mëdhenj të jeni në moshë, aq më tepër gjasa ka që dhimbja të zgjatë. Vaksina kundër herpesit ul rrezikun që të sëmurëni me herpes dhe PHN.

A mund të përhapet herpesi?

Herpesi nuk përhapet aq lehtë sa lia, por lëngu në filluska përmban virusin e lisë. Prandaj, dikush që nuk është imun ndaj lisë mund të infektohet nëse bie në kontakt me këtë lëng.

Nëse keni një skuqje herpesi, duhet ta mbuloni pjesën e skuqur me rroba të lirshme për të ulur rrezikun e përhapjes së lisë. Gratë shtatzëna që nuk e kanë kaluar linë, njerëzit që kanë sistem imunitar të dobësuar dhe foshnjat e sapolindura duhet të shmangin kontaktin e drejtpërdrejtë me lëkurën e skuqur.

Kush do ta bëjë vaksinën?

Duke filluar nga 1 shtatori 2023, programi i vaksinës u ofrohet njerëzve të mëposhtëm:

1

njerëzit e shëndetshëm 70 deri në 79 vjeç që nuk janë vaksinuar ende

2

njerëzit nga mosha 50 vjeç me sistem imunitar shumë të dobësuar

3

njerëzit e shëndetshëm të moshës 60 deri në 70 vjeç kualifikohen për vaksinën kur mbushin 65 ose 70 vjeç

Ju do të mbeteni të kualifikuar për vaksinën kundër herpesit derisa të mbushni 80 vjeç (përveç nëse keni sistem imunitar të dobësuar!), por sa më herët ta bëni vaksinën, aq më herët do të jeni të mbrojtur. Detaje të personave që do ta bëjnë vaksinën në pesë vitet e para të programit tregohen në tabelë.

Po njerëzit që janë nën moshën që kualifikohet për vaksinën kundër herpesit?

Personave më të rinj do t'u ofrohet vakcina kur të arrijnë moshën që kualifikohet.

Herpesi mund të shfaqet në çdo moshë, por rreziku, ashpërsia dhe komplikacionet rriten me kalimin e moshës. Personat që kanë sisteme imunitare tepër të dobësuar janë më të rrezikuar, dhe kjo është arsyeja pse vakcina rekomandohet në një moshë më të hershme.

[1] Njerëzit që kanë sistem imunitar tepër të dobësuar mbeten të kualifikuar për vaksinën.



Nëse bëni vaksinën kundër herpesit, do të merrni një kartë regjistrimi me emrin tuaj dhe datën kur do të bëni takimin e radhës. Ju lutemi ta mbani në një vend të sigurt.



A do të ketë efekte anësore?

Efektet anësore nga vaksina Shingrix janë zakonisht të lehta dhe nuk zgjatin shumë. Efektet anësore më të shpeshta (ndodhin në të paktën 1 në çdo 10 njerëz) janë dhimbja dhe skuqja në vendin e injektimit, dhimbjet e përgjithshme muskulore dhe dhimbja e kokës.

Mund të ndiheni të lodhur dhe të keni temperaturë pas vaksinës Shingrix. Ju mund të pushoni dhe të merrni dozën normale të paracetamolit (ndiqni këshillat në paketim) që të ndiheni më mirë. Mos përdorni makineri ose mos drejtoni automjetin nëse nuk ndiheni mirë.

Duhet të ndiheni më mirë pas disa ditësh, por nëse simptomat zgjatin më shumë, duhet të flisni me mjekun e përgjithshëm ose me infermierin.

Mund të raportoni çdo efekt anësor duke përdorur skemën Yellow card nga (yellowcard.mhra.gov.uk) – shihni faqen e pasme të kësaj fletushke për hollësi.

Sa e sigurt është vaksina Shingrix, a është përdorur në shtete të tjera?

Njëlloj si të gjitha vaksinat e licencuara, vaksina kundër herpesit është testuar plotësisht dhe i plotëson kërkesat e rrepta të MB-së për sigurinë dhe licencimin.

Ajo është përdorur gjerësisht në Evropë dhe në Amerikën e Veriut gjatë viteve të fundit.

Sa e efektshme është vaksina kundër herpesit?

Duke bërë vaksinën, do të ulni ndjeshëm rrezikun për shfaqjen e herpesit.



Në 5 vitet e para pasi u prezantua programi i parë i vaksinimit kundër herpesit, kishte 40,500 më pak konsultime me mjekët e përgjithshëm për sëmundje që lidheshin me herpesin dhe 1,840 më pak shtrime në spital².

Nëse ju shfaqet herpesi, ka gjasa që simptomat të jenë më të lehta dhe sëmundja të jetë më e shkurtër nga ç'do të ishte nëse nuk do ta kishit bërë vaksinën. Vaksina Shingrix e përdorur në MB është vërtetuar se siguron mbrojtje të mirë.

Si dhe kur bëhet vaksina?

Si shumica e vaksinave, vaksina do të bëhet me anë të injektimit në pjesën e sipërme të krahut.

Shingrix është një vaksinë jo e gjallë, dhe do t'ju nevojiten 2 doza që të keni mbrojtjen më të mirë afatgjatë.

Për shumicën e njerëzve, doza e dytë e Shingrix do të jepet nga rreth 6 muaj pas dozës së parë. Nëse keni një sistem imunitar tepër të dobët, doza e dytë e Shingrix duhet të jepet më herët, por të paktën 8 javë pas dozës së parë.

Mjeku juaj i përgjithshëm do t'ju tregojë se kur të lini takim për dozën e dytë.

[2] Ndikimi i programit të vaksinimit kundër herpes zoster në shtrimin në spital dhe në praktikën e përgjithshme në 5 vitet pas prezantimit të tij në Angli: një studim i bazuar në popullatë – PubMed (nih.gov)

Pse nuk mund ta bëj vaksinën tani?

Në programin aktual, të gjithë personat nga mosha 70 deri në 79 vjeç kualifikohen për vaksinën kundër herpesit. Programi zgjerohet gradualisht, duke filluar nga personat që janë më tepër të rrezikuar, siç rekomandohet nga Joint Committee Vaccination Immunisation (JCVI). Në 10 vitet e ardhshme, programi do të përfshijë të gjithë personat nga mosha 60 vjeç.

Personat e moshës 50 vjeç e sipër që kanë sistem imunitar tepër të dobësuar kualifikohen tashmë për vaksinën Shingrix.

A ka nevojë të bëj diçka për të marrë vaksinën?

Kur kualifikoheni për vaksinën kundër herpesit, klinika e mjekut të përgjithshëm do t'ju kontaktojë për të lënë një takim. Megjithatë, nëse jeni të shqetësuar për herpesin, duhet të kontaktoni klinikën e mjekut të përgjithshëm për këshilla.

A ka njerëz që nuk duhet ta bëjnë vaksinën Shingrix?

Nëse keni pasur reaksion të rëndë ndaj ndonjë substance në vaksinë, mund të mos jeni në gjendje ta bëni vaksinën. Mjeku juaj i përgjithshëm do t'ju njoftojë.

A mund të më shkaktojë herpesin vaksina?

Vaksina Shingrix nuk mund t'ju shkaktojë herpesin. Nëse ju shfaqet një skuqje e lëkurës, mund të telefononi NHS 111 ose klinikën e mjekut të përgjithshëm për këshilla.

Po nëse nuk arrij ta bëj vaksinën? A mund ta bëj më vonë?

Për shumicën e njerëzve, vaksina kundër herpesit do të ofrohet derisa të bëhen 80 vjeç. Megjithatë, nëse keni sistem imunitar tepër të dobësuar, vaksina mund të jepet deri në çdo moshë.

Për mbrojtjen më të mirë, duhet ta bëni vaksinën ose të përfundoni kursin e vaksinimit në kohën e rekomanduar. Kontaktoni mjekun e përgjithshëm për të lënë një takim tjetër.

A kualifikohem për vaksinën Shingrix nëse kam bërë Zostavax më parë?

Nëse keni bërë Zostavax si pjesë e programit të zakonshëm të vaksinimit kur ishit në moshën 70 deri në 79 vjeç, nuk ju nevojiten 2 doza të vaksinës Shingrix tani.



Mos u vononi, nëse kualifikoheni, përpiquni ta bëni vaksinën sa më shpejt të jetë e mundur.



Mos harroni, kur kualifikoheni për vaksinimin duhet të lini një takim për ta bërë vaksinën sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të keni mbrojtjen më të mirë.


Informacione të mëtejshme

Nëse doni më shumë informacion para ose pasi keni bërë vaksinën, flisni me mjekun e përgjithshëm ose infermierin. Gjithashtu mund të vizitoni faqen e internetit të NHS në www.nhs.uk/shingles


Për të lexuar më shumë rreth vaksinës Shingrix® vizitoni www.medicines.org.uk/emc/product/12054/pil

Nëse keni një sistem imunitar tepër të dobësuar (të imunosupresuar rëndë), do t'ju ofrohet vaksina kundër herpesit nga moshja 50 vjeç

Ju kualifikoheni pasi të mbushni 70 vjeç

KUALIFIKOHENI NGA (MOSHA JUAJ)	DATAT E LINDJES	DAT E NISJES SË PROGRAMIT	VITI I PROGRAMIT
 70	1 shtator 1953 - 31 gusht 1954	1 shtator 2023	Viti 1
	1 shtator 1954 - 31 gusht 1955	1 shtator 2024	Viti 2
	1 shtator 1955 - 31 gusht 1956	1 shtator 2025	Viti 3
	1 shtator 1956 - 31 gusht 1957	1 shtator 2026	Viti 4
	1 shtator 1957 - 31 gusht 1958	1 shtator 2027	Viti 5

Ju kualifikoheni pasi të mbushni 65 vjeç

KUALIFIKOHENI NGA (MOSHA JUAJ)	DATAT E LINDJES	DATA E NISJES SË PROGRAMIT	VITI I PROGRAMIT
 65	1 shtator 1958 - 31 gusht 1959	1 shtator 2023	Viti 1
	1 shtator 1959 - 31 gusht 1960	1 shtator 2024	Viti 2
	1 shtator 1960 - 31 gusht 1961	1 shtator 2025	Viti 3
	1 shtator 1961 - 31 gusht 1962	1 shtator 2026	Viti 4
	1 shtator 1962 - 31 gusht 1963	1 shtator 2027	Viti 5

Herpesi

është një sëmundje e shpeshtë që mund të shkaktojë dhimbje të rënda që zgjatin



mund të shkaktojë kruajtje të rënda me filluska



mund të shfaqet në çdo moshë, por rreziku, ashpërsia dhe komplikacionet rriten me kalimin e moshës



Vaksina

ul ndjeshëm numrin e rasteve



ul ashpërsinë e simptomave te personat e vaksinuar nëse u shfaqet sëmundja



është përdorur gjerësisht në shtete të tjera, si SHBA dhe Kanadaja



Bërja e vaksinës së zakonshme kundër herpesit është një mënyrë e mirë për t'u kujdesur për shëndetin në mënyrë që të vazhdoni jetën pa dhimbjen e herpesit

Mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara të vaksinave dhe mjekimeve nëpërmjet skemës Yellow Card

Kjo mund të bëhet online ose duke vizituar **yellowcard.mhra.gov.uk** ose duke telefonuar Yellow Card në **0800 731 6789**. Gjithashtu mund të përdorni kodin QR ose mund të shkarkoni aplikacionin Yellow Card.



Shingles Support Society

Faqe interneti: **shinglessupport.org.uk**. Linja telefonike konfidenciale: **0845 123 2305** nga ora 09:00 deri në 21:00, ose **020 7607 9661** nga e hëna në të premte, 12:00 deri në 20:00. Pyetje: **0300 030 9333**



Palsia faciale

Faqe interneti: **facialpalsy.org.uk**



Linja telefonike për shqetësimet për dhimbjet

Telefon: **0300 123 0789**, email: **help@painconcern.org.uk**
Faqe interneti: **www.painconcern.org.uk**



© Crown copyright 2024
Product code: C24SGX1AL Albanian
1p 100K OCT 2024 (APS)
UK Health Security gateway number: 2024623
Larger font for accessibility

If you would like to order more copies of this leaflet, or another format such as large print, braille or as a translated copy please visit **www.healthpublications.gov.uk** or phone: 0300 123 1002, Minicom: 0300 123 1003 (8am to 6pm, Monday to Friday).

www.nhs.uk/vaccinations